



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Tiranë, më 15.12.2020

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektorit, datë 15.12.2020 “Mbi shpalljen e konkursit për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **15.12.2020 deri më 21.12.2020**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialiteteve ku aplikon.

DEPARTAMENTI I SPORTIT

Moduli: “Basketboll” (Bachelor)	1(një) As/Lektor
Moduli: “Volejbol” (Bachelor)	1(një) As/Lektor
Moduli: “Ski” (Bachelor)	1(një) As/Lektor
Moduli: “Turizëm” (Bachelor)	3(tre) As/Lektor
Moduli: “Not” (Bachelor)	2(dy) As/Lektor
Moduli: “Orjentim” (Bachelor)	1(një) As/Lektor
Moduli: “Hendboll” (Master Profesional)	1(një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për Lektor, dhe As/Lektor në modulet përkatëse, në Departamentin e Sportit janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në nivelin Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Specialitetin e lëndës përkatëse ku konkuron. **15 pikë**
2. Të ketë notë mesatare të studimeve të larta mbi 8 (tetë). **15 pikë**
3. Të ketë përvojë pune Akademike mësimdhënëse e kërkimore në fushën përkatëse në Institucionet e Arsimit të Lartë. **25 pikë**
4. Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE : anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi. **10 pikë.**
5. Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë(me dëshmi). **10 pikë**
6. Kanë preference kandidatët që kanë Grada dhe Tituj shkencor. **15 pikë**
7. Të ketë kryer aktivitet shkencor si: referime, botime Brenda dhe jashtë vendit. **3 pikë**
8. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie. **1 pikë**
9. Të ketë eksperiencë praktike dhe specializim në fushat përkatëse. **3 pikë**
10. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës. **3 pikë**
 - Kandidati që konkuron për “Lektor” duhet te kete graden shkencore “Doktor”, dhe kriteret nga 1 deri në 2 janë kriteret bazë dhe kandidati që nuk

plotëson qoftë dhe një të tjetër prej tyre skualifikohet. Kriteret nga 3 deri në 10 janë preferenciale.

- Kriteret për “As/Lektor” nga 1 deri në 2 janë kritere bazë dhe kandidati që nuk plotëson qoftë dhe një të tjetër prej tyre skualifikohet. Kriteret nga 3 deri në 10 janë preferenciale.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qartë mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (*fotokopje*) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

- I. Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- II. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.
- III. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron KASA